



STATUTI I ORGANIZATËS JOQEVERITARE

Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Gjakovës

“HANDIKOS GJAKOVË”

Themeluar në pajtim me Ligjin Nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare
në Republikën e Kosovës

Gjakovë, 2021

Ky statut do të qeverisë shoqatën jofitimprurëse **Handikos Gjakovë**, të themeluar në pajtim me Ligjin Nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

Neni 1 **Emri, forma dhe adresa**

1. Organizata do të quhet **Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Gjakovës**
2. Ajo mund të njihet edhe si **Handikos Gjakovë**
3. Organizata është shoqatë jofitimprurëse, sipas definimit të dhënë në nenin 16 dhe 20 të Ligjit Nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.
4. Organizata nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo të ardhure neto ose fitimi si të tillë për asnjë person. Pasuria, të ardhurat dhe fitimet e organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të organizatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar përfitime të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo tërthorazi për asnjërin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësit, ndonjë anëtar të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donator të OJQ-së. Megjithatë pagesa e kompensimit të arsyeshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona bëjnë për këtë organizatë.
5. Çdo transaksion ndërmjet OJQ-së dhe një organizate tjetër të ndërlidhur, apo ndërmjet OJQ-së dhe anëtarëve, zyrtarëve, anëtarëve të bordit ose punonjësve të saj ndalohet, përveç, nëse organi drejtues vendos, pas hetimeve të arsyeshme, se transaksioni është në interes, i drejtë dhe i arsyeshëm për OJQ-në, dhe se OJQ-ja nuk kishte mundur të sigurojë marrëveshje më të favorshme me përpjekje të arsyeshme dhe brenda rrethanave ekzistuese.
6. Organizata mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të saja jofitimprurëse, në pajtim me paragrafin 1.4 të këtij Statuti dhe nenin 35 të Ligjit për Lirim të Asociimit në OJQ Nr.06/L-043 , me kusht që të ardhurat e realizuara nëpërmjet të aktiviteteve ekonomike të shfrytëzohen ekskluzivisht për të arritur qëllimet e theksuara në këtë statut.
7. Organizata e ka zyrën e saj qendrore në **Rr. Tivari, p/n, Gjakovë, 50000, Kosovë**

Neni 2 **Themeluesit**

1. Themelues të organizatës janë:
 - a. Islam Kasumaj, Rr.Lek Dukagjini, Nr.162, Gjakovë
 - b. Sanija Toljaj, Rr. Nënë Tereza nr 137/21, Gjakovë
 - c. Hysen Avdullahu, Fshati – Popoc, rr. Dëshmorët e Popocit, Komuna e Gjakovë
 - d. Rilind Hoxha, Rr. Bujar Roka nr 35, Gjakovë
 - e. Ahmet Binaku, Rr. Anton Qetta, nr 13, Gjakovë
2. Kuvendi i Anëtarëve vendos për përfaqësuesin e autorizuar të OJQ-së, i/e cili/a përfaqëson organizatën dhe pranon të gjitha shkresat zyrtare në emër të organizatës. Ai ose ajo është përgjegjës

për informimin e autoriteteve kompetente për çfarëdo ndryshimi në të dhënat e deklaruara në rastin e regjistrimit të organizatës.

Neni 3 **Qëllimi**

1. Organizata është themeluar me qëllim të:

- *Mbrojtjes së personave me aftësi të kufizuara*
- *Përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara*
- *Ofrimit të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara*
- *Pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në jetën publike*

2. Fushëveprimtaria e Organizatës:

Për t'i përmbushur qëllimet e saj, organizata do të ndërmarrë, por nuk do të kufizohet vetëm në këto lloje të aktiviteteve:

- përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara në nivelin komunal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- bashkëpunimit me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, për fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara;
- promovimit dhe mbrojtje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara;
- arritjes së pozitës së barabartë në shoqëri të personave me aftësi të kufizuara;
- përmirësimit të mirëqenies sociale të personave me aftësi të kufizuara;
- ofrimit të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, përmes rehabilitimit primar fizikal, psiko-social, shërbimeve sociale dhe familjare për shërbimet nga ligji përkatës për shërbime sociale dhe familjare;
- ofrimi të edukimit joformal për personat me aftësi të kufizuara, duke avokuar për përfshirje e tyre në edukimin formal në shkollat e rregullta;
- ngritjes së vetëdijes së shoqërisë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara;
- pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në politikë bërjen dhe legjislacionin që prek të drejtat dhe interesat e personave me aftësi të kufizuara, si në nivelin komunal ashtu edhe qendror;
- ofrimi i pajisjeve ndimëse për personat me aftësi të kufizuara, siç janë: karroca, shëtitore, paterica, dyshekë antidekubitar, shtretër, karroca tualet;
- ofrimi i shërbimeve të nevojshme me material dhe asistencë profesionale për material të inkontinencës, trajtim të plagëve dekubitare, vizita shtëpiake me shërbime infermierike dhe mjekësore për personat me aftësi të kufizuara;
- zhvillimi të aktiviteteve rekreative për personat me aftësi të kufizuara;
- zhvillimit të aktiviteteve sportive për personat me aftësi të kufizuara;
- zhvillimit të aktiviteteve kulturore për personat me aftësi të kufizuara;

- ofrimit të këshillave dhe shërbimeve juridike për personat me aftësi të kufizuara me qëllim të realizimit të të drejtave të tyre;
- promovimit të të drejtave për punësim të personave me aftësi të kufizuara;
- ofrimit të përkrahjes për personat me aftësi të kufizuara, përmes shkëmbimit të përvojave nga vetë personat me aftësi të kufizuara dhe profesionistëve të licencuar.
- Shërbimet do të jenë falas.

Neni 4 **Anëtarësimi**

1. Anëtarësimi në organizatë është i hapur për çdo person me aftësi të kufizuara me vendbanim në Komunën e Gjakovës, pavarësisht prej racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. Për t'u anëtarësuar në organizatë, secili i interesuar duhet të pranojë Statutin dhe Misionin e organizatës dhe të angazhohet për përmbushjen e qëllimeve të organizatës. Çdo person me aftësi të kufizuar nën moshën 18 vjeçare, mund të anëtarsohet me autorizim të prindit/kujdestari. Çdo person me aftësi të kufizuar i cili ka statutin e pa mundësisë në vendimarrje, mund të antarsohet nga familjari ose përfaqësuesi i autorizuar nga familja .

- 1.1. Me rregullore të veçantë do të caktohen kriteret për vlerësimin apo njohjen e cilësimin të aftësisë së kufizuar, regjistrimin, evidentimin dhe librezat e anëtarësisë
- 1.2. Çdo person me aftësi të kufizuar në territorin e Komunës së Gjakovës ka të drejtë të jetë anëtar në Organizatë.

2. Kuvendi i anëtarëve do të vendos nëse do të kërkohet pagesa e anëtarësimin nga anëtarët. Në rast të vendosjes së pagesës së anëtarësimin, Kuvendi do të vendosë për rregullat dhe procedurat e pagesës së anëtarësimin, përfshirë marrjen e masave të ndryshme, deri në përjashtimin e anëtarit nga organizata në rast të mospagesës së anëtarësisë.

3. Anëtarësimi i ndonjë anëtari gjithashtu mund të përfundojë ose suspendohet me vendimin e Kuvendit të Anëtarëve në rast të mos pagesës së anëtarësisë nëse është e aplikueshme pagesa e anëtarësisë, mungesës së pa-arsyeshme për tri herë radhazi në mbledhjet e kuvendit të anëtarëve, përhapjes së propagandës së rreme kundër shoqatës, veprimeve kundër shoqatës, veprimeve diskriminuese dhe ofenduese kundër anëtarëve, keqpërdorimit të mjeteve dhe pasurisë së shoqatës. Në rast të suspendimit, kohëzgjatja e suspendimit do të përcaktohet me vendimin të nxjerrur nga Kuvendi dhe i përcaktuar me rregullore të veçant.

4. Çdo anëtar ka për obligim të nënshkruaj deklaratën e konfidencialitetit dhe konfliktit të interesit të paraparë me rregulloret e Organizatës.

5. Përfundimi ose suspendimi i anëtarësimin nga Kuvendi i Anëtarëve do të vendoset me shumicë të anëtarëve prezent.

Neni 5

Kuvendi i Anëtarëve

1. Kuvendi i Anëtarëve është organi më i lartë qeverisës i organizatës. Ai përbëhet prej të 25 personave, të cilë zgjidhen nga lista e anëtarëve të antarësuar në Organizatë.

1.1. Anëtarët zgjedhin kuvendin e anëtarëve

1.2. Prej 150 anëtar të organizatës, zgjedhen 25 anëtar të Kuvendit të anëtarëve të cilët zgjedhen me propozim të vetë anëtarëve të Organizatës, sipas rregullorës së përcaktuar për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit.

2. Kuvendi i Anëtarëve ka përgjegjësinë më të lartë për politikën dhe çështjet financiare të organizatës. Në këtë kuadër, Kuvendi i Anëtarëve ka kompetencë të zgjedhë dhe të shkarkojë zyrtarët në pozita udhëheqëse të OJQ-së si: Drejtorin Ekzekutiv, Bordin e Organizatës, pozita tjera udhëheqëse, të aprovojë raportet periodike financiare dhe të punës, të interpretojë dhe ndryshojë Statutin, si dhe të vendosë për bashkimin, ndarjen apo shuarjen e OJQ-së. Këto përgjegjësi nuk mund të delegohen në organet tjera më të ulta.

3. Përpos përgjegjësive të rezervuara që ka, Kuvendi i Shoqatës gjithashtu ka edhe këto përgjegjësi:

- *Miratimin dhe Ndryshimin e Rregulloreve të ndryshme brenda Organizatës*
- *Miratimin dhe kërkim ndryshim/plotësim të Strategjisë së Organizatës*
- *Raportime periodike dhe mbledhe të jashtëzakonshme në të mirën e Organizatës*

4. Kuvendi i Anëtarëve mund të delegojë ndonjë prej përgjegjësive të tij në organin tjetër udhëheqës të ndërmjetm (p.sh. Bordi, Kryesia, Këshilli Drejtues) ose edhe të punësuar të organizatës, me vendimin e shumicës së anëtarëve të tij, me përjashtim të përgjegjësive të cilat nuk delegohen sipas nenit 31 të Ligjit Nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe paragrafit 2 të Neni 5 të këtij Statuti.

Neni 6

Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve

1. Kuvendi i Anëtarëve do të takohet së paku një herë në vit në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (MPV) ku shqyrtohet dhe miratohet raporti për mjetet, deyrimet, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e kaluar, si dhe plani për mjetet, e detyrimet e parapara, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e ardhshëm.

2. Kuvendi i Anëtarëve mund të takohet gjithashtu edhe në Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme (MPJ) kurdoherë që kërkohet nga (*p.sh. gjysma e anëtarëve*) ose nga organet tjera të ndërmjetme siç janë: Bordi i Organizatës ose Ekzekutivi. Një kërkesë e tillë duhet t'i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit të Anëtarëve i cili do të lajmërojë për takimin të gjithë anëtarët, në pajtim me procedurat e përcaktuara në paragrafin vijues.

3. Lajmërimi me shkrim për MPV dhe/ose MPJ, duke përfshirë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës për mbledhjen do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve së paku shtatë ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.
4. Për mbajtjen e mbledhjes është e nevojshme pjesëmarrja e më shumë se gjysmës së anëtarëve. Nëse ky kuorum nuk arrihet në tentimin e parë, takimi do të shtyhet për një ditë të përcaktuar më vonë dhe lajmërimi i ri do t'u dërgohet të gjithë anëtarëve.
5. Secili anëtar i organizatës ka një votë në Kuvendin e Anëtarëve.
6. Vendimet në Kuvendin e Anëtarëve do të merren me shumicën e anëtarëve prezent (50% plus 1 anëtar)
7. Asnjë anëtar i Kuvendit të Anëtarëve nuk i lejohet të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje ku ai ka interes direkt apo indirekt ekonomik. Anëtar i Kuvendit të Anëtarëve konsiderohet se ka interes ekonomik nëse ai/ajo, ose cilido anëtar i familjes së tij ka interes direkt apo indirekt ekonomik.
8. Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve zgjedhet nga Kuvendi i Anëtarëve me shumicë të votave (50% plus një anëtar) dhe i udhëheq mbledhjet e Kuvendit. Në rastet kur Kuvendi bën zgjedhjen e Drejtorit, Bordit apo trupave tjerë udhëheqës, Kuvendi në fillim e zgjedhë kryesinë e punës prej 4 anëtarëve e cila kryesi e punës udhëhiqet nga Kryesuesi i Kuvendit dhe së bashku konsiderohet kryesi e punës prej 5 anëtarëve.

Neni 7

Organi udhëheqës i ndërmjetëm (Bordi)

1. Bazuar në përgjegjësitë e dhëna me këtë statut, organi udhëheqës i ndërmjetëm Bordi Ekzekutiv duhet të veprojë çdo herë në pajtim me qëllimin e organizatës.
2. Bordi do të ketë këto përgjegjësi:
 - Bordi jep këshilla të ndryshme për Drejtorin dhe Kuvendin e Anëtarëve, për të drejtat dhe përgjegjësitë e organeve të shoqatës, për çështjet e përgjegjësiave financiare të shoqatës, për çështjet e bashkëpunimit dhe partneritet të shoqatës me institucione dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare, për çështjet e planeve financiare dhe të punës, për çështjet e raportimeve të shoqatës tek donatorët dhe institucionet vendore, për çështjet e hartimit dhe implementimit të projekteve dhe për ndonjë çështje tjetër që i kërkohet nga Kuvendi i Anëtarëve apo Drejtori.
 - Bordi monitoron punën e Drejtorit dhe zyrtarëve tjerë ekzekutiv në lidhje me zbatimin e Statutit, Planeve, Strategjive dhe projekteve, për zbatimin e Rregullores Financiare dhe Rregulloreve tjera të shoqatës.
 - Pas çdo monitorimi, Bordi harton raport dhe i raporton Kuvendit të Anëtarëve, duke dhënë edhe rekomandime për ndonjë çështje.

- Kur Bordi e vlerëson të nevojshme, mund të rekomandon Mbledhje të Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Kuvendit të Anëtarëve për të shqyrtuar çështjet e vlerësuara nga monitorimi.
- Bordi ka të drejtën e kërimit të raporteve nga Drejtori Ekzekutiv dhe njëherit të marr pjesën në monitorimin e kritereve të përpiluara për shërbimet apo projektet e caktuara
- Bordi ka të drejtën e kërimit të shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv nga Kuvendi i Anëtarëve në rastet kur janë shkelur detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv, ose nuk janë përmbushur ato në bazë të planit vjetor ose strategjisë së Organizatës

3. Bordi zgjedhet nga Kuvendi i Anëtarëve. Ata do të zgjedhen individualisht me shumicë të votave (50% plus 1 anëtar) nga anëtarët e pranishëm. Mënyra e zgjedhjes dhe rregullat e punës së anëtarëve të Bordit mund të rregullohen me një Rregullore të veçantë për punën e Bordit, e cila aprovohet nga Kuvendi i Anëtarëve me shumicë votash.

4. Bordi do të ketë 5 anëtarë, njëri nga të cilët duhet të zgjedhet si Kryesues i Bordit. Anëtarët duhet të jenë personat që kontribuojnë për personat me aftësi të kufizuara dhe nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Anëtarëve dhe që nuk janë të punësuar në Organizatë dhe që nuk kanë asnjë interes ekonomik në Organizatë.

5. Anëtarët e Bordit **mund** të zgjedhen për mandate të njëpasnjëshme, por jo më shumë se 3 (tre) mandate.

6. Anëtarët e Bordit mund të shkarkohen para përfundimit të mandatit me shumicë votash të Kuvendit të Shoqatës, nëse:

- Ndaj tyre është shkelur e drejta e qëllimeve të Organizatës
- Janë shkelur kodi etik dhe i mirësjelljes nga ndonjëri prej anëtarëve
- Është bërë pjesëmarrës i ndonjë konflikti të interesit drejt aktiviteteve dhe qëllimeve të Organizatës
- Ndonjë shkelje tjetër që parashihet me rregullore apo udhëzime të Organizatës që bien ndesh me përgjegjësitë që ka Anëtari i Bordit
- Bëhet pjesë e ndonjë anëtarësimi i subjektit politik ose posti politik
- Ndonjë arsye tjetër që konsiderohet me shumicë votash si shkelje për anëtarin e Bordit

7. Mandati i anëtarit të Bordit pushon:

Në rast të vdekjes,
dorëheqjes ose
shkarkimit nga Kuvendi i Anëtarëve.

8. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të Bordit, Kuvendi i Shoqatës duhet të zgjedh pasardhësin për të shërbyer për kohën e mbetur/me mandat të ri, ose ushtrim detyre të Mandatit.

9. Vendimet në Bord merren me shumicë votash të anëtarëve prezentë (50% plus 1 anëtar).

10. Bordi mund të vendosë t'i drejtohet për çfarëdo çështje Kuvendit të Anëtarëve për marrje të vendimit.

11. Kurrëfarë pagese ose kompenzimi nuk duhet t'u bëhet anëtarëve të Bordit pa aprovimin e Kuvendit të Anëtarëve dhe vetëm kur pagesa ose kompenzimi është i arsyeshëm dhe bëhet për punën e kryer për organizatë.

12. Asnjë anëtar i Bordit nuk i lejohet të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje ku ai ka interes direkt apo indirekt ekonomik. Anëtar i Bordit konsiderohet se ka interes ekonomik nëse ai/ajo, ose cilido anëtar i familjes së tij ka interes direkt apo indirekt ekonomik.

13. Në mbledhjet e Bordit mund të marrin pjesë edhe pjesëmarrës të shoqëris civile ose anëtar të organizatës.

Neni 8

Drejtori Ekzekutiv

1. Bazuar në përgjegjësitë e dhëna me këtë statut, Drejtori Ekzekutiv është njëherit edhe përfaqësues i autorizuar i Shoqatës dhe gjithmonë duhet të veprojë në pajtim me këtë statut, qëllimin e organizatës dhe ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Drejtori Ekzekutiv është përfaqësues me të drejta administrative dhe juridike për menaxhimin e Organizatës në bazë të Statutit dhe rregulloreve tjera në fuqi.

2. Drejtori zgjedhet nga Kuvendi i Anëtarëve, me shumicë të votave të anëtarëve (50% plus një anëtar)

3. Drejtori ka mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje për mandate të njëpasnjëshme.

4. Përgjegjësitë e Drejtorit janë:

4.1 Është përfaqësues i autorizuar i Shoqatës dhe është përgjegjës para ligjeve dhe organeve shtetërore për veprimet dhe mos-veprimet e tij si përfaqësues i autorizuar

4.2 Përfaqëson Shoqatën pranë organeve shtetërore për përgjegjësitë ligjore të Shoqatës, për avokim dhe lobim, e përfaqëson Shoqatën pranë organizatave dhe institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, me aprovim të Kuvendit të Anëtarëve miraton dhe i nënshkruan propozim-projektet, nënshkruan marrëveshjet për implementim të projekteve, nënshkruan marrëveshje dhe memorandume, me aprovim të Kuvendit të Anëtarëve nënshkruan kontratat e të punësuarve dhe kontratat tjera për Shoqatën.

4.3 I përgjigjet dhe raporton pranë Bordit Ekzekutiv dhe Kuvendit të Anëtarëve

5. Mandati i Drejtorit pushon: Në rast të vdekjes, dorëheqjes ose shkarkimit nga Kuvendi i Anëtarëve.

Neni 9 Zyrtarët dhe Nëpunësit

1. Në rast nevoje organizata punëson persona që të marrin përsipër kryerjen e detyrave ditore të organizatës.
2. Zyrtarët duhet të punësohen në përputhje me Ligjin e Punës në Republikën e Kosovës, të gjitha të ardhurat dhe të mirat e tjera që duhet t'i paguhen Zyrtarit, si dhe obligimet dhe përshkrimin e punës dhe përgjegjësiive të Zyrtarit. Të gjitha pagesat duhet të jenë të arsyeshme dhe duhet të paguhen vetëm për punën e kryer për organizatë.
3. Kuvendi nxjerrë rregullore të veçantë për rregullimin e marrëdhënieve të punës, mëditjeve dhe të drejtave dhe detyrimeve duke u bazuar në Ligjin përkatës të Punës dhe Kontratës Kolektive
4. Shoqata, duke u bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjit të veçantë për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, në bazë të kriterëve dhe kualifikimeve adekuate prioritet në punësim do ti jep personave me aftësi të kufizuara.

Neni 10 Shpërbërja e organizatës

1. Organizata mund të shpërbëhet me vendimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit të Anëtarëve dhe nënshkrimin e pëlqimit të më shumë se 50% e anëtarëve të Organizatës
2. Kur të vendos për shpërbërjen e organizatës, Kuvendi i Anëtarëve do të tregojë emrin e Organizatës joqeveritare në Republikën e Kosovës që do të marrë pasurinë e mbetur pasi të jenë paguar borxhet e organizatës. Organizata joqeveritare e zgjedhur duhet të ketë qëllim të njejtë ose të ngjajshme sikurse organizata.

Neni 10

Ndryshimet e statutit

1. Statuti i tanishëm mund të ndryshohet me vendimin e dy të tretave e anëtarëve prezentë të Kuvendit të Anëtarëve.

Neni 11

Periudhat e Raportimit dhe Viti Financiar

1. Bordi dhe Zyrtarët e emëruar do të paraqesin raporte vjetore para Kuvendit të Anëtarëve, MPV ose kurdoherë që kërkohet nga një MPJ.
2. Viti financiar i organizatës do të përputhet me vitin kalendarik.

Ky statut është aprovuar në **Gjakovë**

Më 15.10.2021

Nga Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve:

SAHIZA POLLAJ 
Emër, Mbiemër, Nënshkrim
Kryesuesi
